



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		15/07/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	- 052/01 - 27449		

RAPORT I PUNËS

GJASHTËMUJORI I PARË - 2025



Korrik, 2025



RAPORTI I PUNËS

GJASHTËMUJORI I PARË - 2025

Përmbajtja:

Zyra e Kryetarit të Komunës	3
Zyra për Komunikim me Publikun	4
Njësia e Auditimit të Brendshëm	8
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.....	10
Zyra për Integritet Evropian	12
Zyra Ligjore.....	15
Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore	17
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	19
Aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmuajorin e parë të viti 2025 ..	21
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.....	24
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	32
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	34
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	36
Drejtoria e Inspeksionit	37
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	41
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.....	42
Drejtoria Komunale për Arsim.....	49
Drejtoria për Infrastrukturë Publike.....	59
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	60
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.....	61
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.....	62

Zyra e Kryetarit të Komunës

Në periudhën raportuese janar-qershor 2025 në Zyrën e Kryetarit, janë regjistrua përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 1.965 lëndë të ndryshme, ku prej tyre 1.154 janë miratuar, 761 janë në proces për shkak të afateve kohore, 29 janë refuzuar dhe 10 janë anuluar.

Të gjitha lëndët janë procesuar me kohë, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit. Janë nxjerrë 132 vendime të ndryshme, ku ato që kanë pasur karakterin e përgjithshëm, janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës, si dhe për çdo muaj në formatin Word, janë publikuar listat vendimeve dhe të njëjtat janë dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Zyra e kryetarit ka organizuar një (1) takim me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar e raportuar aktivitetet e gjashtëmuajorit të parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë, synimet dhe investimet kapitale.

Janë mbajtur dy dëgjime buxhetore për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore, 2026-2028, për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasit. Po ashtu janë mbajtur edhe 3 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), janë mbajtur edhe 27 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet dhe konkluzionet e nxjerra nga mbledhjet, ku secili drejtor në baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet si dhe janë diskutuar tema të ndryshme.

Të gjitha njoftimet, komunikatat, ftesat dhe dokumentet janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social, Facebook.

Kryetari i Komunës, gjatë kësaj periudhe raportuese ka nënshkruar 11 Memorandume të Bashkëpunimit me Ministri të linjës dhe organizata ndërkombëtare për të realizuar projekte të ndryshme në të mirën e qytetarëve. Të gjitha këto Memorandume, janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës dhe janë të qasshme për të gjithë të interesuarit.

Zyra për Komunikim me Publikun

Raporti i punës Janar – Qershor 2025

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
-I-	Rritja e transparencës dhe mundësive të reja për komunikim	1. Raporti për periudhën Janar-Qershor i Kryetarit për vitin 2025,	Korrik 2025	Zyra për Komunikim me Publikun
		2. Ofrimi i qasjes në Dokumente publike,	36 kërkesa për qasje në dokumente publike, 32 të qasshme =, 4 të refuzuara me vendim.	Zyra për Komunikim me Publikun
		3. Raportimi për Transparencë dhe përmbushjen e obligimeve për ueb faqen zyrtare, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,	Raport është dërguar në qershor 2025.	Zyra për Komunikim me Publikun
		4. Tubimi i parë me publikun	Qershor 2024 – tubimi me publikun ka përfunduar brenda afatit ligjor dhe njoftimi është bërë 14 ditë para mbajtjes së tubimit.	ZKP në bashkëpunim me drejtori dhe zyre komunale
		5. Treguesit e transparencës (Performanca komunale MAPL, OJQ),	Gjatë periudhës raportuese në SIMPK, janë futur të gjitha të dhënat që kanë qenë nga Zyra, ku është mbuluar fusha “Përgjegjshmëria Komunale”	ZKP dhe zyre komunale
		6. Publikimi i vendimeve, procesverbaleve të Kuvendit të Komunës dhe materialeve të Kuvendit e Komitetit.	Pas kthimit të ligjshmërisë nga MAPL, të gjitha vendimet janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës	Sekretaria e Kuvendit përmes ZKP-së

		7. Publikimi i vendimeve dhe urdhëresave të kryetarit të Komunës dhe gjitha dokumenteve të Komunës, duke përfshirë të prokurimit, konkurseve, njoftimeve dhe dokumenteve të tjera në ueb faqen zyrtare,	Të gjitha dokumentet e këtij aktiviteti, janë publikuar në ueb faqe dhe lehtë mund të vërtetohen.	ZKP dhe zyre të tjera komunale
		8. Publikimi i lajmeve/njoftimeve, shpalljeve, konkurseve dhe çdo informatë tjetër që ka të bëjë me informimin e qytetarëve në ueb faqe dhe rrjetin zyrtar social-Facebook	Të gjitha këto të dhëna janë publikuar në ueb faqen zyrtare dhe lehtë janë të vërtetuara.	ZKP
		9. Përcjellja e të gjitha aktiviteteve komunale	Aktivitetet e Komunës janë përcjellë e publikuar sipas afateve.	ZKP
		10. Dhënia e deklaratave për media dhe dërgimi i komunikatave të ndryshme	Për secilën media që ka kërkuar deklaratë, qoftë me shkrim apo në formën elektronike, janë dhënë.	ZKP
		11. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i ueb faqes zyrtare të Komunës dhe rrjetit social Facebook	Vazhdimisht është populluar me të dhënat e kërkuara ueb faqja.	ZKP
		12. Përcjellja e mbledhjeve të Bordit, KKSb-së, KPF dhe Kuvendit të Komunës	Ne këto mbledhje, ka prezantuar çdo herë Zyra për Komunikim me Publikun	Komuna-KK-KPF-ZKP
		13. Ofrimi i fotografive profesionale gjatë takimeve, eventeve, realizimin e projekteve si dhe krijimi i video mesazheve të shkurtra për qytetarët	Zyra për Komunikim me Publikun ka fotografim e zyrës, i cili në mënyrë profesionale ka realizuar detyrat e tij.	ZKP

		14. Publikimi i gjitha dokumenteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare	5 kategoritë e prokurimit, nga njoftimi për dhënie të kontratës, deri të nënshkrimi i kontratës, janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës.	ZKP dhe Zyra e Prokurimit
-II-	Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave publike	1. Konsultimi me qytetarë dhe grupe të interesit para hartimit të politikave publike	Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë mbajtur 2 konsultime publike dhe të gjitha janë zbatuar sipas Udhëzimit për Administratë të Hapur në Komuna	Drejtoritë, ZKP
		2. Konsultimi me qytetarë gjatë planifikimit të buxhetit, (KAB dhe buxhetin)	Në muajin Maj 2025, sipas planit të punës, janë mbajtur dy dëgjime buxhetore dhe janë publikuar të gjitha detajet në ueb faqe te komunës, nga kalendar i dëgjimeve, thirrjes, draft-KAB-in, njoftimet për tubim, mbajtjen e dëgjimeve, hartimi i procesverballi dhe raporti i dëgjimeve si dhe publikimi i tyre në ueb faqen zyrtare.	ZKP, Drejtoria për Buxhet dhe Financa
		3. Përcjellja e objektivave që dalin nga Plani Komunal i Veprimit	Në kuadër të Planit të	

		për Transparencë dhe Rregullores Komunale për Transparencë.	Veprimet, janë përcjellë të gjitha aktivitetet që dalin nga ky dokument. Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, komunat janë detyruar të hartojnë e miratojnë Planin e Veprimeve për Transparencë si dhe Rregulloren Komunale për Transparencë dhe këto dy dokumente janë hartuar e miratuar nga Kuvendi. Në mbledhjen e fundit të mbajtur të Kuvendit të Komunës me datë 30.12.2024, me vota unanime është votuar Rregullorja Komunale për Transparencë dhe Plani i Veprimeve për Transparencë 2025-2028.	ZKP
--	--	--	---	------------

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Puna Janar – Qershor 2025

Sipas nenit 19, pika 2.1 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe në pajtim me Rregulloren QRK nr. 01/2019, Komuna ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik. Po ashtu në pajtim me nenin 20 të këtij Ligji është i formuar edhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2024, ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2025 -2027 si dhe duke u bazuar në këtë Plan , ka miratuar edhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2025.

Bazuar në Planin vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 janë planifikuar të kryhen gjithsej shtatë auditime. Në gjysmë vjetorin e parë ishin planifikuar të kryhen katër auditime të cilat janë kryer në tërësi si dhe janë finalizuar raportet.

Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë këtij gjashtëmujori ka përbushur në tërësi Planin vjetor të punës duke kryer të gjitha auditimet e parapara me këtë Plan.

Raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në dy mbledhjet e rregullta të mbajtura nga ky Komitet në baza tremujore.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrë një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës.

Gjatë këtij gjashtëmujori janë dhënë një numër i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar ku nga ana e menaxhmentit janë ndërmarrë një numër prej 21 aktiviteteve për adresimin e drejtë dhe me kohë të këtyre rekomandimeve.

Llojet e detyrave të auditimit të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025

Nr	Objektivat e detyrës: Të arrihet se:	Aktiviteti	Fusha	Afati	Bartës i aktivitetit
1	Aprovimi i Planit Strategjik për vitet 2025-2027. Aprovimi i Planit Vjetor të Punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025. Aprovimi i Raportit të Gjashtëmujorit të Dytë të vitit 2024. Aprovimi i Raportit vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin e kaluar Fiskal 2024.	Plani Strategjik 2025-2027, dhe Plani vjetor i punës për vitin 2025, Përgatitja e Raporteve të punës për gjashtëmujorin e dytë dhe Raportit vjetor për vitin 2024	Të gjitha Drejtoritë	Janar, 2025	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit të Brendshëm
2	Komuna ka bërë identifikimin dhe regjistrimin e duhur të pasurive. Komuna ka menaxhim dhe ruajtje efektive të pasurive.	Auditimi: Menaxhimi me Pasuritë jo financiare të komunës.	Drejtoria e Financave, Zyrtari i pasurive,	Shkurt, 2025	Njësia e Auditimit të Brendshëm

	Komuna ka mirëmbajtje të saktë të të dhënave për pasuritë përmes mbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive. Komuna bënë harmonizimin e të dhënave mbi pasuritë me kontabilitetin e sektorit publik në përputhje me obligimet ligjore. Komuna ka proces adekuat, eficient dhe transparent të tjetërsimit/zhvendosjes së pasurive.		Zyrtarët pranues		
3	Komuna ka caktuar menaxherët e kontratave në afatin ligjor. Menaxherët e kontratave janë persona adekuat, me kompetenca profesionale dhe pa konflikte interesi. Planet e Menaxhimit të Kontratave janë hartuar në mënyrë profesionale dhe të bazuara në Kontratën e lidhur nga një proces prokurimi. Planet e Menaxhimit të Kontratave janë të përditësuara siq kërkohet edhe me Udhëzues. Ka pasur një përkujdesje për kohen e realizimit të projekteve dhe për materialet e përdorura sipas kontratës.	Auditimi: Menaxhimi me kontrata gjatë vitit 2024 dhe 2025.	Drejtoria e Infrastrukturës, Drejtori i Urbanizmit Drejtorati i Shërbimeve Publike	Mars, 2025	Njësia e Auditimit të Brendshëm
4	Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit	Viti 2024 dhe 2025	Njësitë e audituara	Prill, 2025	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit të Brendshëm
5	Ekziston bazë ligjore dhe organizim përkatës për mbledhjen e të hyrave nga lëshuarja e lejeve dhe dhënia e pronës me qira. Mbledhja, deponimi dhe evidencat në lidhje me të hyrat bëhen me kohë. Ekziston planifikim i duhur i të hyrave. Ka barazim të të dhënave në lidhje me të hyrat e mbledhura. Ka faturime të rregullta të të hyrave për inkasim. Transakcionet regjistrohen me kohë dhe në shumë të duhur.	Të hyrat vetanake nga Lejet e ndërtimit dhe nga prona e dhënë në shfrytëzim, (qiratë).	Drejtoria për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Drejtoria për Buxhet dhe Financa.	Prill 2025	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit të Brendshëm
6	Është bërë shpërndarja e faturave dhe njohtimi i tatimpaguesve me kohë.	Auditimi: Të hyrat vetanake-nga TPR	Viti 2024 dhe 2025.	Maj-Qershor	Njësia e Auditimit të Brendshëm

	Vlera e të arkëtueshmeve nga këto të hyra është në rënie. Të arkëtueshmet trajtohen në mënyren e duhur. Ka Komision të ankesave dhe është aktiv në shqyrtimin e tyre. Ka bazë ligjore dhe organizim të proceseve për mbledhjen e të hyrave. Të hyrat shpenzohen ekskluzivisht për qëllimet e lejuara. Ka azhurnitet në mbledhje, deponim dhe transfer të të hyrave. Ekziston planifikim vjetor i inkasimit të të hyrave. Ka kontrolla të mjaftueshme në lidhje me të hyrat. Ka ndarje të duhur të detyrave . Transakcionet regjistrohen me kohë dhe në shumë të duhur.				
7	-Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit - Shqyrtimi i raporteve Gjashtëmujore për NJQHAB, - Shqyrtimi i shkallës së implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë Gjashtëmujorit të parë 2025.	Njësitë e audituara	Gjashtëmujori i parë 2025.	Qershor 2025	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka azhurnuar listat e pagave sipas ndryshimeve, konform zhvillimeve në stafin e punëtorëve.

Paraqitja në formë tabelore e realizimit sipas azhurnimit në listë të pagave:

Muaji - viti	Punëtor i ri	Ndryshime	Punëtor të larguar	Pagesa retroaktiv	Lista e kuvendit, zjarrfikëseve, etj.
Janar 2025	1	8	1	29	Lista për anët, dhe anët, të KK
Shkurt 2025	/	4	1	15	Lista për anët dhe anët, të KK

Mars 2025	4	6	/	13	Lista për anët. dhe anët. të KK
Prill 2025		9	1	44	Lista për anët. dhe anët. të KK
Maj 2025	/	17	2	40	Lista për anët. dhe anët. të KK
Qershor 2025	2	9	/	37	Lista për anët. dhe anët. të KK

Pra për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës nga muaji Janar 2025 është filluar me konkurse të jashtme.

Pas këtij hapi si dhe interesimi i njësive kërkuese që sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitat e lira të punës, kërkesat për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të ndryshme, si dhe pozitat e lira të punës të planifikuara me PPI për vitin 2025 pas Plotësim – ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore në nivel vendi, është filluar për vitin 2025 me shpallje të konkurseve – pranim (konkurse të hapura-publike në gjashtë mujorin e parë të vitit 2025 janë shpallur pesëmbëdhjetë (15) grup pozitash: pas përfundimit me sukses të procedurave rekrutuese me përzgjedhje janë 11 plotësuar me sukses, 3 raste kanë dështuar si dhe pas përfundimit të procedurave rekrutuese janë fazën e ankimimit në KPMSHCK-së, dhe një (1) është në shqyrtim të ankesës në KPMSHCK.

Me hyrjen në fuqi të ligjit për zyrtarë publik nr. 08/L-197, NJMBNJ është e ngarkuar edhe me procedurat e rekrutimit të zyrtarëve publik për Arsim dhe Shëndetësi, ku gjatë periudhës janar-qershor 2025 janë zhvilluar gjithsej: 48 konkurse për mësimdhënës, 4 konkurse për staf mbështetës në arsim, 2 konkurse për drejtor të shkollave në arsim si dhe 7 konkurse për doktor në shëndetësi.

Nga KPMSHCK: Dosjet personale për disa shërbyes civil, Akt-Emërime, Lista e Pagave për muaj të caktuar, Kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e shërbyesve civil në pushim të lehonisë 2025, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhë të ndryshme mujore, procedura rekrutuese të konkurseve të mbyllura (të brendshme).

Transferimet brenda kategorisë dhe procedura rekrutuese të konkurseve – pranim (konkurse publike), si dhe lidhur me punët dhe detyrat e tjera që dalin nga kompetencat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjigjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore.

Po ashtu Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe njësisia e personelit sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.01/2024 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor, ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa për masë disiplinore.

Zyra për Integritet Evropian

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
1.	Përbushja e obligimeve Komunale nga Agjenda Evropiane Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2022-2026. Raporti i Komisionit Evropian për vendin (Kosovën)	1.1. Raporti vjetor i Kryetarit për vitin 2024, Hartimi i Planit gjithëpërfshirës dhe individual për përbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane Identifikimi i obligimeve të Komunës nga PKZMSA; 1.2. Identifikimi i obligimeve të komunave nga Raporti i vendit ; 1.3. Raporti për zbatimin e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane. 1.4. Matrica gjithëpërfshirëse dhe individuale e raportimit në Komunë;	1.1. Janar 2024 – i përfunduar Janar- Qershor 2025 Përbushur 1.2. Përbushur 1.3.I kryer në afatin kohor 1.4.E përbushur	ZKIE Kryetari MAPL. ZKIE
2	Harmonizimi i aktiviteteve me aktet ligjore të Qeverisë në Koordinimin e procesit të zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës që ndërlidhen me procesin e integritetit evropian dhe që dalin nga dokumente strategjike, si ato nacionale ashtu edhe ato lokale, të këtij procesi, përfshirë pjesëmarrjen në	2.1. Koordinimi i procesit të integritetit evropian. 2.2. Koordinimin e aktiviteteve me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive në Komunë në implementimin e obligimeve që rrjedhin nga PKZMSA-ja dhe aktivitete tjera në funksion të procesit të integritetit evropian Koordinimin me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare të cilat ofrojnë asistencë -përkrahje në implementimin e PKZMSA -së dhe merr pjesë në këto grupe punuese.	2.1. Janar-Dhjetor 2025. I vazhdueshëm 2.2. Janë përcjellë të gjitha aktivitetet që dalin me dokumente të reja, si udhëzimi për administratë të hapur në komuna që ka hy në fuqi, është miratuar plani i veprimit për transparencë si dhe rregulloren komunale për transparencë e që të dyja këto dokumente janë miratuar sipas	ZKIE Zyret e Kryetarit. Drejtorit. ZKP

	caktimin e prioriteteve komunale në këtë aspekt dhe koordinimin e realizimit të obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE; Planin dhe programin e punës që rrjedhin nga implementimi i Planit të Veprimit i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociimit (PVMSA) ,në pajtim me Ligjet, Rregulloret dhe aktet tjera të organeve të pushtetit qendror dhe lokal		procedurave ligjore.	
3	Monitorimi i zbatimit dhe raportimi për obligimet nga agjenda evropiane	3.1. Raport periodik lidhur me përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane Janar – Qershor Korrik – Dhjetor 3.2. Raportimi vjetor në MAPL lidhur me përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga agjenda evropiane.	3.1 Janar-Qershor 2025 I përmbushur Korrik-Dhjetor 2025 I vazhdueshëm	ZKIE në bashkëpunim me drejtori dhe zyre komunale. MAPL.

4	Forcimi i koordinimit ndërinstitutional në procesin e Integritimit Evropian. Takime lidhur me përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane	4.1. Marrja pjesë në takimet të bordit të drejtorëve në fushën e IE. 4.2. Takime të rregullta me drejtorët e drejtorive si dhe shefat e sektorëve përkatëse sa i përket përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga PKVMSA-së -ja. 4.3. Marrja pjesë në mbledhjet për planifikim buxhetor. 4.4. Marrja pjesë në takime dhe trajnime në MAPL, MIE dhe Ministri e institucione të tjera që kanë të bëjnë me integritime evropiane. 4.5. Marrja pjesë në Kolegjin e ZKIE të Asociacionit të Komunave të Kosovës me Zyrtarët tjerë komunalë për Integritime Evropiane.	4.1. Njoftim dhe pjesëmarrje në takime në Fushën e Integritimeve Evropiane. 4.2.I Vazhdueshëm 4.3. Përcjellja dhe marrje pjesë në planifikimet dhe dëgjimet buxhetore. 4.4. Pjesëmarrje në takime që i ka organizuar MAPL-OSBE e Ministri tjera lidhur me procesin e IE. 4.5. Pjesëmarrje në hartimin e planit të punës të kolegjiut për integritime evropiane, si dhe sfidat që kanë dalë nga raporti i MAPL-së dhe i vendin për Kosovën	ZKIE ZKP, drejtorja për buxhet dhe Financa, të gjitha Drejtorit dhe Zyrat. ZKIE. ZKIE MAPL
5	Adresimi i sfidave të komunave që dalin nga Raporti i komisionit Evropian për vendin (Kosovën) Raportimi Kryetarit dhe	5.1. Organizim dhe bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e drejtorive e shefa të sektorëve për realizimin e obligimeve të komunave të cilat dalin nga agjenda evropiane dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi lidhur me këto obligimeve. 5.2. Raportimi vjetor Kryetarit dhe në MAPL.	5.1I Vazhdueshëm	ZKIE Drejtorit Kryetari MAPL.

	MAPL-së, nga Përmbyshja e Obligimeve Komunale nga Agjenda Evropiane në baza periodike dhe sa herë që kërkohet.		5.2 I vazhdueshëm	
			5.2.I përmbyshur në afatet kohore	

Zyra Ligjore

Raporti i punës për periudhën Janar-Qershor 2025

Në kuadër të obligimeve ligjore dhe përshkrimit të punëve që ka Zyra Ligjore e Drenasit, më poshtë e gjeni Raportin e Punës e zyrës ligjore të Komunës së Drenasit për periudhën Janar-Qershor 2025.

Departamenti ligjor në kuadër të Zyrës së Kryetarit në Komunën e Drenasit në vazhdimësi punon drejt krijimit të një sistemi ligjor i cili garanton hartimin e akteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, hartimin dhe procesimin e shkresave juridike për lëndët gjyqësore në të cilat Komuna Drenas/Gillogoc është palë në procedurë si me vetëiniciativë ashtu edhe sipas obligimit të dhënë nga gjykata, përmbajtje dhe formë të aktit normative sa më të saktë si nga aspekti përmbajtësor ashtu edhe nga aspekti teknik, mendime juridike, profesionale dhe rekomandime tjera në përmbyshjen e ligjshmërisë sa i përket organeve komunale si dhe përshtatje të procedurave, teknikave dhe mjeteve materiale me nevojat e fushë veprimatrisë përkatëse.

Raporti është paraqitur me objektiva, aktivitete, bartës të aktiviteteve, me afate kohore.

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
-I-	Pranimi, shqyrtimi, dhe proceduar tutje në organet administrative, gjyqësore apo edhe brenda vet institucionit, këto lëndë:	- 250 Përgjigje në Padi	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor.	ZK
		- 60 Ankesa të parashtruara për në Gjykatën e Apelit	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor.	ZK

		- 42 Fjalë përfundimtare	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor.	
		- 27 Përgjigje në Kërkesë	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor.	ZK
		- 15 Vendime të hartuara	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor.	ZK
		- 01 Padi	Ka përfunduar brenda afati ligjor	ZK
		- 1360 Propozime përmbarimore	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor.	ZK
		- 6 Prapesime	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor	
-II-	Përfaqësimi i Komunës së Drenasit pranë të gjithë gjykatave në Republikën e Kosovës.	- 152 Seanca gjyqësore	Janë mbajtur në bazë të datës së planifikuar nga ana e Gjykatës.	ZK
		- 30 Parashtrës të cilat përfshijnë: përmbushjen e obligimeve të gjykatave të dhëna sipas aktvendimeve në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore	Janë dorëzuar në gjykatë brenda afatit të caktuar për mbajtjen e seancës.	ZK

-III-	Të Tjera	Në kuadër të departamentit ligjor në kuadër të Zyrës së Kryetarit në Komunën e Drenasit mes tjerash janë kryer edhe hartimi i detyrimeve Kontigjente sipas kërkesës së ZKF-së dhe Brenda afateve të parapara me ligj, realizimi i detyrave në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative dhe procedurat teknike dhe duke marr parasysh praktikat profesionale si dhe janë dhënë këshilla dhe opinione ligjore në të gjitha rastet që është kërkuar nga ana e Drejtorive përkatëse.	Kanë përfunduar brenda afatit ligjor	ZK
-------	----------	--	--------------------------------------	----

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Raport Janar – Qershor 2025

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
-I-	Implementimin e ligjeve vendore që janë në funksion të të drejtave të njeriut, por edhe konventave ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejtë	15. Përpilohmë Raporte narrative tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetor të punës.	Raportet iu dorëzohen ABGJ, MAPL, ZQM	Njesia për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore
		16. Përpilohmë pyetësor dhe raporte të monitorimit të kërkuar nga MAPL, ZQM dhe ABGJ, në formë tabelare.	Raportet iu dorëzohen ABGJ, MAPL, ZQM	NJDNJZBGJ
		17. Ndryshim-plotësimi i vendimit të Këshillit Koordinues për mbrojtjen e viktimave të dhunës në baza Gjinore	Vendimi ia kam dorzuar ABGJ, MAPL, ZQM dhe antarëve	NJDNJZBGJ
		18. Mbajmë takime me Këshillit Koordinues për mbrojtjen e viktimave të dhunës në baza Gjinore	Me 06.02.2025, salla e Bordit	NJDNJZBGJ
		19. Kërkesë për Planin Lokal për barazi gjinore drejtuar UN WOMEN	Me 03.02.2025	NJDNJZBGJ
		20. Raport i funksionimit të Njësitit për vitin 2024	Raport me 07.02.2025, për trajnim i dërguar MAPL	NJDNJZBGJ

në Kushtetutën e Republikës së Kosovës	21. Ligjëratë për parandalimin e martesave të hershme dhe parandalimin e ngacmimit seksual në shkollë, në shkollën "Shotë Galica" Tërdec dhe në shkollën "Migjeni" Baicë	Raporti me 28.02.2025, i është dorëzuar MAPL, ABGJ, ZQM	NJDNJZBGJ
	22. Punëtori për Planin Lokal të veprimit për mekanizëm të Këshillit Komunal Koordinues për mbrojtjen e viktimave të dhunës në baza gjinore	Me 10. 03. 2025, në N'hije Zabel i Poshtëm	NJDNJZBGJ dhe UN Women
	23. Pjesëmarrësit në kampanjen vetedijësuese në rrjetet sociale të projektit Demos për 8 Mars	Me 06.03.2025	NJDNJZBGJ dhe DEMOS
	24. Aktivitet online i zyrës përmes Web-faqes së komunës me rastin e 8 Marsit	Me 07.03.2025	NJDNJZBGJ
	25. Vizita institucioneve dhe OJQ-ve me rastin e "8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas-Femrës", Vizita në QPDG, QKMF, QPS, Shtëpinë Integruese të Shëndetit Mendor.	Raport, me, 07.03.2025 dërguar ABGJ, dhe MAPL, ZQM	NJDNJZBGJ
	26. Vlerësimi Ex-post për Ligjin Nr. 06L-084 për mbrojtjen e fëmijëve	Raport me 11.03.2025	NJDNJZBGJ dhe MAPL
	27. Konsultim publik për Planin Lokal të Veprimit Zbutes për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna nga grave dhe vajza	Me 04.04.2025, Salla e Kuvendit	NJDNJZBGJ
	28. Aktivitet për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të personave me Sindrom Down	Me 21.03.2025, Handikos	NJDNJZBGJ dhe Handikos
	29. Aktivitet për shënimin e 2-Prillit Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizëm	Me 03.04.2025	NJDNJZBGJ dhe DKA
	30. Miratimi i Vendimit për Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në baza gjinore	Me 29.04.2025	NJDNJZBGJ
	1. Rekomandim për organizimin e programit për 1 Qershorin, për të gjitha SHFMU të komunës së Drenasit	SHFMU Drenas	NJDNJZBGJ

-II-	Promovimi i të drejtave të njeriut në komunitet	2. Aktivitet me rastin e 1-Qershorit, Dites Nderkombetare për të drejtat e fëmijëve	Me 30.05.2025	NJDNJZBGJ dhe DKA, DKRS
		3. Takim me Ekipën për të drejtat e fëmijëve	Me 10.06.2025, Salla e Bordit	NJDNJZBGJ
		4. Njoftim për të gjitha shkollat rreth 12-Qershorit-Dites Nderkombetare për parandalimin e punëve të renda dhe mbajtja e dy ligjëratave në Nekoc dhe Fushticë e Poshtme	12.06.2025	NJDNJZBGJ

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Raporti i punës Janar – Qershor 2025

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
-I-	1. Buxheti për vitin 2026-2028 i hartuar dhe i aprovuar (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 10.1) 2. Pjesëmarrja e rregullt në takimet që mbahen në Komunë (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 7.1.7)	31. Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ZKKK do të avokoj për buxhet të mjaftueshëm për 2026	I përfunduar	ZKKK, ZK, DBF-ZKF
		32. Udhëheqësi i zyrës në bashkëpunim me zyrtarin për financa do të hartoj buxhetin për vitin 2026	I përfunduar	ZKKK
		33. Krijon kalendarin e aktiviteteve të zyrës	I përfunduar Trajnim për të drejtat e komuniteteve në Kosovë mbajtur më 18,19 Mars. Takimet – si anëtare e Komisionit për vlerësimin e rreziqeve dhe planin për reagim emergjent - 2 takime	ZKKK
		34. Merr planin vjetor të takimeve të KK-së dhe mban takime të rregullta me Komitetin për Komunitete si dhe takimet me KKS	I përfunduar Kemi mbajtur 2 takime me KK, temë e diskutimeve Plani i punës së KK dhe raportim nga	ZKKK, ZK

-II-	1.Çështjet specifike dhe nevojat e të gjitha komuniteteve, personave të riatdhesuar janë të adresuara tek institucionet lokale	35. Takimet me anëtarët e Kolegjiut për Komunitete dhe Kthim, si anëtarë e këtij Kolegjiut	ZKK, 4 takime me KKSBB. Kemi mbajtur punëtorin e parë të kolegjiut dhe kemi punuar planin e punës së Kolegjiut.	AKK, KZKK
		36. Raportim i rregullt tek Kryetari, Asambleja Komunale, Komiteti për Komunitete, nëse kërkohet tek institucionet qendrore, për implementimin e projekteve për personat e riatdhesuar dhe komunitetet.	Në baza të rregullta 2025	ZKKK
		7. Raporti gjashtë mujor	I përfunduar dorëzuar tek ZK, ZKK, MPB	ZKKK
	2.Plani i Komunal i Veprimt për Riintegrimin e personave të Riadatdhesuar 2023-2025	Këshillimi i personave të riatdhesuar	Këshillimi në baza ditore, te riintegruar kemi 16 persona, të riatdhesuar kemi 11 persona (6M, 5F) Verifikimi në teren është bërë i të gjitha rasteve së bashku me MPB.	ZKKK
		4. Referimi i personave të riatdhesuar tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre 5. Komisioni Komunal për Riintegrim 6. Regjistrimi civil 7. Qasje ne Punësim, Arsim Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe dikaster të tjerë 8. Ngritja profesionale për vetëpunësim 9. Ngritje profesionale e personave të riatdhesuar (Trajnime duke u pajisur me Diploma) dhe me mjete pune\	Në baza të rregullta Kemi mbajtur 1 takime të KKR, kemi marr vendim për dy kërkesa: 1 vazhdim akomodimi, 1 gjera ushqimore-higjienike. Janë pajisur me dokumente të gjendjes civile Në zyrën e punësimit janë paraqitur dhe kanë marrë informatat e nevojshme të	ZKKK, ZP, QPS
	3.Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkomëtare "GIZ", "CARITAS" Org. "AKTI" "AWO", "IOM"			
	4.Procesi i Migrimit pas			

	liberalizimit të vizave	10. Ndihmë personave të riatdhesuar me cënueshmëri	gjithë personat e riatdhesuar. 1 familje (4 anëtarëshe) dhe një person kemi me Asistencë sociale.	
		11. Pjesëmarrja e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, në takime punëtori aktivitete të tjera.	1 familje vazhdim akomodimi, gjëra ushqimore dhe higjienike, këshilla psikologjike. Në baza të rregullta	
		12. Të dhënat nga tereni për numrin e personave të larguar nga vendbanimet e tyre	Me Org. "INTEGRA", kemi fillimin e projektit për parandalimin e emigrimit të rinjve	
		13. Raport mbi procesin e migrimit	Në procesin e migrimit kemi 120 persona të larguar nga vendbanimet e tyre gjatë këtij gjashtë mujori 2025, të dhënat nga tereni nga Këshillat Lokale.	

ZKKK,
KKSBB, KK,
MAPL

Aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmuajorin e parë të viti 2025

Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për gjashtëmuajorin e parë të viti 2025

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për funksionimin e Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi, konkretisht nenin 9, pika 1.8, i cili përcakton obligimin e kryesuesit të KKSBB-së për informimin e Kuvendit Komunal mbi aktivitetet e Këshillit, ju paraqes këtë raport për periudhën Janar–Qershor 2025.

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe nenin 11, pika 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 janë mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta të KKSBB-së. Këto mbledhje janë organizuar në përputhje me Planin e Punës dhe janë shpallur publikisht në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit së paku shtatë (7) ditë përpara mbajtjes së tyre.

Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera që kanë dalë gjatë mbledhjeve nga anëtarët e KKSBB-së. Për tri mbledhjet është hartuar procesverbal që është publikuar në ueb faqe, gjithashtu është dërguar edhe në MAPL, Divizioni për Siguri në Bashkësi.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSBB-së dhe monitorues, ku zakonisht kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit nga KFOR. Në një nga mbledhjet ka qenë pjesëmarrës edhe monitorues, zyrtar nga MPB.

Në vijim paraqesim një përmbledhje të mbledhjeve të mbajtura, temave të diskutuara, institucionet përgjegjëse dhe rekomandimet apo konkluzionet kryesore:

Data e Mbledhjes	Temat e Diskutuar	Përgjegj ësit	Rekomand imet / Konkluzio net Kryesore
Mbledhja e parë: 30.01.2025 Linku: https://gllogoc.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/01/20250122145213282.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 12.12.2024, https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2025/01/1477.pdf 2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit; 3. Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror;	Koordina tori i KKSBB- së, Drejtorët	Të forcohet gatishmëria për mirëmbajtje e rrugësh në lagjet periferike

Mbledhja e dytë: 17.04.2025 Linku: https://gllogoc.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/04/mbledhja-me-date-17-prill-2025.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 20.02.2025: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2025/02/Proceverbal-i-KKSB-se-date-30.01.2025.pd; 2. Siguria e përgjithshme në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni i Policisë në Drenas; 3. Të ndryshme	Policia, Drejtorët	Të forcohen masat e parandalimit të vjedhjeve, zbatimi i Planit Operativ të Policisë; Të kërkohet mbikëqyrje më e rreptë nga inspektorati për punimet në rrugë; Parandalimi i hedhjes së mbeturinave jo inerte në deponinë në Llapushnik; Të rritet bashkëpunimi me Policinë, Ministrinë dhe qytetarët për adresimin e çështjeve të Sigurisë.
Mbledhja e tretë: 05.06.2025 Linku: https://gllogoc.rks-gov.net/ftese-per-mbledhjen-e-keshillit-komunal-per-siguri-ne-bashkesi-per-daten-05-06-2025/	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 17.04.2025: https://gllogoc.rks-gov.net/keshilli-komunal-per-siguri-ne-bashkesi/	Drejtoria e Arsimit, Policia	Të organizohet aktivitetet vetëdijësuese në shkollë dhe lagje; Rritja e bashkëpunimit me akterë të

	2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit;		sigurisë dhe prindërit
	3. Aktivitetet në parandalimin e dukurive negative tek të rinjtë;		
	4. Të ndryshme		

Përveç KKSBB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ, gjithsej 3 takime.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Raporti në vijim paraqet punën e sektorëve të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme gjatë periudhës Janar- Qershor 2025 duke u bazuar në planin e punës.

I. Sektori i Gjendjes Civile

Sektori i Gjendjes Civile ka përmbushur objektivat e planit të punës duke ofruar shërbime për qytetarët me efikasitet, pa pritje në sportele. Sipas statistikave të nxjerra nga sistemi i GJC-së, në afatin e paraparë ligjor dokumente për përdorim të brendshëm janë lëshuar 11 727, dokumente për përdorim të jashtëm 9 366, që në total janë 21 033. Ndërsa, gjatë vitit 2025 kemi ofruar shërbime elektronike edhe përmes E-kioskës në Komoran dhe në Drenas. Nga E-kioska në Komoran janë lëshuar 132 dokumente, ndërsa në Drenas janë lëshuar 365 dokumente.

Nga sistemi i Gjendjes Civile, nga data 01.01.2025 deri me 30.06.2025 për përdorim të brendshëm janë lëshuar këto dokumente:

1. Ekstrakte të lindjes- 7.629
2. Certifikata të lindjes- 403
3. Certifikata të martesës 1171
4. Certifikata të vdekjes 656
5. Certifikata të vendbanimit- 181
6. Certifikata të shtetësisë 30
7. Certifikata të Gjendjes martesore 472

8. Certifikata të Bashkësisë Familjare 1105

9. Vërtetim nga arkiva 80

TOTALI- 11 727

Ndërsa, dokumente të lëshuara për përdorim të jashtëm nga sistemi i Gjendjes Civile janë si në vijim:

1. Ekstrakte të lindjes - 1363
2. Certifikata të lindjes - 4856
3. Certifikata të martesës - 1461
4. Certifikata të vdekjes - 170
5. Certifikata të vendbanimit – 623
6. Certifikata të shtetësisë - 48
7. Certifikata të statusit martesor -173
8. Certifikata të bashkësisë familjare -553
9. Vërtetime nga arkiva -119

TOTALI- 9 366

-Aktvendime për ndërrime të emrit dhe mbiemrit, regjistrime të mëvonshme të lindjes, vdekjes, gjithsej 129

-Kërkesa për humbje të shtetësisë së Kosovës- 6

-Kërkesa për fitim të shtetësisë së Kosovës – 50

II. Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve janë regjistruar 9,250 lëndë. Në këtë sektor të gjitha kërkesat e qytetarëve janë adresuar me kohë nëpër drejtoritë dhe zyrat komunale, duke treguar efikasitet, profesionalizëm dhe përkushtimin ndaj qytetarit. Siç shihet nga tabela me poshtë, në muajin Qershor ka pasur më së shumti regjistrim të lëndëve me 1,974.

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
		1. Janë pranuar dhe regjistruar <u>1,607</u> lëndë të ndryshme, të	Janar 2025	QSHQ

-I-	Shërbime efikase ndaj qytetarëve (9,250 lëndë)	klasifikuara sipas shenjave klasifikuese		
		2. Janë pranuar dhe regjistruar <u>1,223</u> lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese	Shkurt 2025	QSHQ
		3. Janë pranuar dhe regjistruar <u>1,399</u> lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese	Mars 2025	QSHQ
		4. Janë pranuar dhe regjistruar <u>1,614</u> lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese	Prill 2025	QSHQ
		5. Janë pranuar dhe regjistruar <u>1,433</u> lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese	Maj 2025	QSHQ
		6. Janë pranuar dhe regjistruar <u>1,974</u> lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese	Qershor 2025	QSHQ
-II-	Rritja e shërbimeve efikase dhe punët shtesë në menaxhim	Qendra për shërbimin e qytetarëve në komunë bashkëpunon me drejtorit komunale dhe njësit organizative brenda drejtorive komunale. Qendra pranon dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtorit komunale dhe njësit organizative brenda drejtorive. Po ashtu punë tjera si: - Bashkëngjitja dhe miratimi i lëndëve në sistemin e intranetit. - Menaxhimi i kontratave në cilësinë e menaxheres (obligim me vendim nga Kryetari). - Gjatë këtij gjashtëmujori është punuar edhe në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPL “Stacioni i Autobusëve” Drenas.	Janar-Qershor 2025	QSHQ

III. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2025 ka përfunduar të gjitha punët dhe detyrat sipas Planit të punës, ku me sukses ka realizuar gjithsej 63 procedura të prokurimit sipas kërkesave të Njërive Kërkuese.

Nr. Rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
-I-	Administrimi i të gjitha procedurave të prokurimit për vitin fiskal 2025	1. Raporti vjetor i kontratave	Janar	Zyra e Prokurimit
		2. Raporti gjashtemujor i Zyres së Prokurimit	Qershor	Zyra e Prokurimit
-II-	Procedurat e Inicuar	1. Procedura të hapura	Gjatë vitit 2025, janë inicuar - 34	Zyra e Prokurimit
		2. Koentim çmimi	Gjatë vitit 2025, janë inicuar - 12	Zyra e Prokurimit
		3. Vlera minimale	Gjatë vitit 2025, janë inicuar - 6	Zyra e Prokurimit
		4. Procedura të negociuar dhe pune shtese	Gjatë vitit 2025, janë inicuar - 4	Zyra e Prokurimit
		5. Anulime	Gjatë vitit 2025, janë inicuar - 7	Zyra e Prokurimit

IV. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta

Zyrtarja për pranim-Freebalanc: Është bërë pranimin dhe evidentimin e të gjitha pagesave nga drejtoritë komunale. Raporte të pranimin nga freebalanc- GRNS janë nxjerrë gjithsej 281.

Zyrtarja për E-depo: Është bërë shkarkimin dhe ngarkimin me inventarit jashtë përdorimit sipas kërkesave të zyrtareve. Është bërë shkarkimi i 10 zyrtareve më asete. Ngarkimi i 37 zyrtareve me asete, janë regjistruar 25 fatura. Ndërsa më material shpenzues janë ngarkuar 92 zyrtar.

Recepcionisti: Udhëzimi i palëve në të gjitha Drejtoritë/Zyrat. Gjatë periudhës janar - qershor 2025, kanë qenë rreth 1796 qytetarë që kanë kërkuar shërbime në drejtoritë komunale, zyrën e kryetarit vetëm në katin II,III të cilët janë regjistruar në evidencë.

Postieri: Është bërë shpërndarja e postës për të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale. Gjatë periudhës janar-qershor 2025 janë shpërndarë 1043 shkresa të ndryshme (vendime, aktvendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj.) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe në institucionet e ndryshme në Prishtinë.

Gjithashtu fokisti/mirëmbajtësi: ka bërë mirëmbajtjen e parkut, ka përcjellë punën e nxemjes, klimës për objektin e komunës si dhe punë e detyra tjera brenda dhe jashtë objektit të komunës sipas kërkesave dhe nevojave, (brenda objektit të komunës).

Elektriciisti: Ka kryer detyra sipas kërkesave të paraqitura nga zyrtaret, sidomos rregullimi i dritave, rregullimin e problemeve me klima nëpër zyra.

Mirëmbajtësi i Automjeteve: gjatë periudhës janar - qershor 2025 ka kryer këto detyra të punës, ka menaxhuar kontratën e furnizimit me karburante dhe kontratën furnizim me goma për Institucionet Komunale.

Furnizim me karburant, nr. i furnizimeve	Sasia e furnizimit në liter	Furnizim me benzinë nr. i furnizimeve	Furnizim me karburant, naftë për nxehje	Furnizim me karburant, naftë për gjenerator.
141 furnizime te automjeteve	6240.52 litër dizel	1 furnizim 19.05 lit. benzin.	////////////////////	1 furnizim 126.01-liter dizel

V. Sektori Arkivit

Numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë fizike për të gjitha programet për periudhën Janar-Qershor është 941. Ndërsa, numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet është **9948**.

1.	Zyra e Kryetarit te Komunës	356
2.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme dhe z. e Kuvendit.	525
3.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	0
4.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	0
5.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	0
6.	Drejtoria i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	0
7.	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	0

8.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	0
9.	Drejtoria për Arsim	0
10.	Drejtoria për Kulturë, Rrini dhe Sport	0
11.	Drejtoria i Inspektimit Komunal	60
12.	Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencë	0
13.	Zyra për Komunitete dhe kthim	0
14.	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	0

Sektori i arkivit kryen edhe punë tjera në shërbime për qytetarë si:

1. Deklatatë për ushqim për vitin kalendarik [mbajtës i familjes] për Bashkatdhetarë për të gjitha shtetët 353 lëndë
2. Certifikatë për shtesa të fëmijëve për punëtorët që kanë punuar në shtetet e huaja- 3 lëndë
3. Vertetim mbi jetën për të gjithë bashkatdhetarët - 29 lëndë
4. Deklaratë e udhëtimit për shtetas të huaj - 2 lëndë
5. Legalizimin e të gjitha dokumenteve nga original - 17 lëndë

Për këto shërbime në gjashtëmuorin 2025 kemi proceduar 404 lëndë

VI. Zyra për Teknologji Informative

Nr. rendor	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
-I-	Administron, menaxhon dhe mirëmban sistemin e TI-ve, dhe proceseve të qeverisjes elektronike në administratën e komunës.	1. Menaxhon rrjetin në objekt të komunës	Janar-Qershor	ZTI
		2. Menaxhon rrjetin në disa institucione tjera shtetërore Komunale	Janar-Qershor	ZTI
		3. Mirëmban pajisjet e IT në Komune	Janar-Qershor	ZTI
		4. Ndihmon dhe mbështet të gjitha stafin në përdorimin e pajisjeve të IT-së	Janar-Qershor	ZTI
		5. Mban kontakte të rregullta me ASHI-në në implementimin e proceseve të e-Qeverisjes në MAP	Janar-Qershor	ZTI
			E vazhdueshme	ZTI
-II-	Planifikon, dizajnon, integron, siguron (bazën	1. Krijon llogarit në Intranet për shfrytëzues	Janar-Qershor	ZTI
		2. Siguron bazën e të dhënave të Intranetit.	Janar-Qershor	ZTI

	e te dhënave), barte, freskon, menaxhon dhe mbështet sistemet dhe kërkesat ne fushën e TI-se.	3. Ep privilegjet për shfrytëzues	Janar-Qershor	ZTI
		4. Mirëmban Active directory	Janar-Qershor	ZTI
		5. Ruan te dhënat ne DT ne ASH	Janar-Qershor	ZTI
-III-	Udhëheq dhe koordinon procesin e freskimet dhe përpunimit te mëtutjeshëm te strategjisë ne nivel komunal me investimet ne e-Qeverisje, ne përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve komunale. Menaxhon dhe udhëheq me pajisjet e tel.	1. Komunikon me posten elektronike me këshilltar	Janar-Qershor	ZTI
		2. Administron dhe konfiguron tel VoIP e.	Janar-Qershor	ZTI
		3. Krijon llogarit për këshilltar, mirëmban dhe ndihmon këshilltaret.	Janar-Qershor	ZTI
		4. Instalon sistemet operative sipas UA	Janar-Qershor	ZTI
		5. Mbikëqyr sistemin e sigurisë.	Janar-Qershor	ZTI
		6. Është pjese e grupeve punuese ne nivel vendi për te gjitha aplikacionet digjitale lokale dhe migrimin e shërbimeve komunale ne platformën eKosova	Janar-Qershor	ZTI
			Janar-Qershor	ZTI
-IV-	Ndihmon ne implementimin e proceseve te e-shërbimeve dhe aplikacioneve ne komune si: (Intraneti, Ueb-faqja, e-pasuria, GJC, Arka, etj.) Dhe te zhvilloj shërbimet e e-qeverisjes ne	1. Ndihmon shfrytëzuesit ne aplikacionin e GJC	Janar-Qershor	ZTI
		2. Menaxhon aplikacionin e intranetit	Janar-Qershor	ZTI
		3. Ndihmon shfrytëzuesit ne aplikacionin e TP	Janar-Qershor	ZTI
		4. Ndihmon shfrytëzuesit ne te gjitha aplikacione	Janar-Qershor	ZTI
		aplikacionet ne komunë	Janar-Qershor	ZTI
		5. Menaxhimi i ueb faqe dhe dizajnimet e kërkuara.	Janar-Qershor	ZTI
		6. Ndihmon në te gjitha aplikacioneve tjera ne komune.	Janar-Qershor	ZTI

	institucionet komunale si dhe trajnon dhe mbështet stafin ne përdorimin e aplikacioneve.			
-V-	Siguron dhe mbron te gjitha te dhënat qe ruhen ne serverët e komunës, menaxhon me llogarit zyrtare, domaini dhe krijon te reja.	1. Kryen punë me sukses te hapjes se e-mailave zyrtar për të gjitha kërkesat e tyre.	Janar-Qershor	ZTI
		2. Administrimi i dhomës së serverëve dhe sigurinë e tyre	Janar-Qershor	ZTI
		3. Ka ruajtur shënimet nga Outlook	Janar-Qershor	ZTI
		4. Është përkujdesur për vazhdimin e qasjes dhe resetim te pasvordëve.	Janar-Qershor	ZTI
		5. Është krijuar qasja e punëtoreve ne sistemet, SIMBNJ, SVMP, S MAED e aplikacione tjera, janë kryer kërkesat online për ID dhe shërbime tjera.	Janar-Qershor	ZTI

VII. Zyra e Kuvendit Komunal

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës Janar- Qershor 2025, ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politik e Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi Komunal ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, dhe 3 mbledhje solemne.

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
Komuna Gillogoc (Drenas)	6 mbledhje Janar, 31.01.2025 https://gillogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Ftesa-e-mbledhjes-se-rregullt-te-KK-te-dt.-31.01.2025.pdf	0	0	3 mbledhje

	Shkurt, 28.02.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Ftesa-dhe-Materiali-i-KK-per-mbledhjen-e-28.02.2025.pdf			14.02.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Ftesa-per-mbledhjen-solemne.pdf
	Mars, 28.03.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Ftesa-dhe-materjali-i-mbledhjes-se-KK-e-dt-28.03.2025.pdf			05.03.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/ftesa-e-mbledhjes-solemne-05.03.2025.pdf
	Prill, 29.04.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Ftese-dhe-procesverbali-i-mbledhjes-se-Kuvendit-te-Komunes.pdf			
	Maj: 29.05.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Ftesa-dhe-materiali-i-mbledhjes-se-rregullt-te-dt.-29.05.2025.pdf			
	Qershor. 30.06.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Ftesa-dhe-materiali-i-mbledhjes-se-Kuvendit-Komunal-dt.-30.06.2025.pdf			13.06.2025 https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Ftesa-per-mbledhje-solemne.pdf

Gjatë periudhës Janar - Qershor janë miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas, gjithsej: 30 vendime, prej tyre 27 janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe nga 30 vendime 3 prej tyre janë shfuqizuar, ndërsa vetëm një është rishqyrtuar.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, gjatë periudhës Janar-Qershor /2025, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, rregulloret,

vendimet, udhëzimet e MFPT dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Kjo Drejtori, punën e vetë kryesisht e ka orientuar në këto lëmi:

- Raporti i punës dhe financiar për vitin 2025,
- Pasqyrat Vjetore Financiare 2024,
- Aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi,
- Kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e SIMFK,
- Punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat),
- Regjistrimi në sistem i të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,
- Shpërndarja e faturave për vitin 2025,
- Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- Raporti sipas periodave të vitit 2025,
- Zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2026-2028, sipas kërkesave fillestare,
- Përgatitja e Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore komunale 2026-2028,
- Punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- Punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave,
- Numri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal,
- Lëshimi i fletëpagesave sipas kërkesës së palëve,
- Është bërë arkëtimi i parave të imta për shërbime në ofiçari, arkiv, Gjeodezi, Urbanizëm, shërbimet e pagesës së tatimit në pronë – shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveç arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës,
- Regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në databazë dhe në sistemin e Free-balancit,
- Barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
- Hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MFPT,
- Zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes dhe sipas modulit të aprovimit,
- Kryerja e pagesave,
- Certifikimi i pagesave,

- Raporti i obligimeve të papaguara,
- Është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e certifikuara sipas shpenzimeve veç e veç,
- Raporti financiar për periudhën Janar-Mars /2025,
- Plani i punës për vitin 2025,
- Fletëpagesa të lëshuara.

Zyra e Tatimit në Pronë

Gjatë kësaj periudhe Zyra e Tatimit në Pronë ka kryer këto punë dhe detyra, si dhe ka ofruar këto shërbime:

- Verifikime të objekteve në terreni,
- Modifikime të dhënave të pronës,
- Modifikime të dhënave të tatimpaguesve,
- Njoftime përfundimtare të dërguara,
- Vendime për ankesat/kërkesat për korrigjim,
- Ndërrime të pronarëve,
- Korrigjimet manuale të dhënave financiare,
- Krijime të relacioneve,
- Të dhënat e relacioneve të modifikuara,
- Lëndët e miratuara në intranet ZTPR,
- Marrëveshje për pagesë me këste,
- Lëshimi i certifikatave për jo tatimpagues,
- Certifikata të lëshuara për pagesë,
- Fatura të shpërndara përmes postës,
- Pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja,
- Lëshimi i vërtetimeve për viza,
- Letërkujtesa për tatimpagues – obligimet e papaguara,
- Shpronësime të pronave me kontratë po ashtu me deklaratë të përbashkët,
- Lëshimi i faturave sipas kërkesës së palëve,
- Kërkesa/ankesa.

Nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën raportuese (Janar-Qershor /2025), janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe N.P.H. “Ibër Lepenc” Sh.A

- Nga ky memorandum do të përfitojnë fermerët e komunës tonë subvencionimin e ujitjes për 250 hektar. Me këtë marrëveshje përfitojnë të gjithë fermerët që kanë të mbjella mbi

0.50ha e më shumë me kultura bujqësore që gjenden në zonat ku është i shtrirë sistemi i ujitjes.

Ky memorandum është duke u zhvilluar.

Projektet nga Komuna në bashkëpunim tre vjeçar me IADK-në

- Është bërë thirrje për aplikim në projektin digjitalizim dhe ndryshimet klimatike në perime në sera dhe pemëtari/pemë të imëta(dredhëza dhe mjedra).
- Në këtë projekt kanë aplikuar gjithsej 4 fermerë, prej tyre 1 është përzgjedhur përfitues në rrjetëzim të serave.
- Trajnim dhe këshilla direkte për fermerin përfitues të këtij projekti i mbajtur nga IADK.

Punë tjera të kryera nga DBZHR

- Është bërë monitorimi i projektit të vitit 2023-Makina mbjellëse të misrit.
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve pranverore, sipas të dhënave nga terreni këtë vit janë mbjellë rreth 2378 ha. Vlen të ceket që këtë vit kemi të mbjellë 13.50ha bimë industriale (luledielli).
- Në bashkëpunim me MBPZHR dhe organizatën KDC (Qendra Kosovare për Zhvillim) në kuadër të projektit “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshillimore” janë mbajtur trajnime për fermerët e komunës. Trajnimet e mbajtura nga janari deri me tani janë:
 - Krasitja e pemëve drufrutore.
 - Përdorimi i plehrave të drithërat e bardha dhe masat agroteknike që ndikojnë në rritjen e rendimentit.
 - Kultivimi i perimeve (spec, domate, tranguj etj.) në sera dhe fushë të hapur.
 - Sëmundjet ngjitëse të lopët qumështore dhe rëndësia e vaksinimit.
 - Mirëmbajtja dhe menaxhimi i bletishteve

Projektet nga MBPZHR-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

- Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, kanë aplikuar **59 fermerë** për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë sipas kategorive: Ekstra klasë 0.07 €, klasa e parë 0.04€, klasa e dytë 0.02 € ndërsa për majmëri të viçave subvencionimi për 1 krerë ka qënë 25 €,
- **Për pagesa direkte për vitin 2025, kanë aplikuar 1218 fermer** në te gjitha sektorët e bujqësisë: grurë, farë gruri, elb, thekër, misër, luledielli, vreshta, pemë, perime në serra,

perime në fushë të hapur, lopë dhe buallica qumështore, dele, dhi, bletë, pula vojse, bimë aromatike etj.

Planifikimi për pjesën tjetër të viti

- Projekte për përkrahjen e fermerëve në mekanizëm bujqësor.
- Përcjelljen e fushatës së korrije-shirjeve.
- Vazhdimin e trajnimeve për fermerë sektorë të ndryshme
- Monitorim të projekteve etj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Gjatë periudhës Janar- Qershor për vitin 2025, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM) ka zbatuar me përkushtim planin vjetor të punës, duke ndjekur objektivat strategjike dhe detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacioni në fuqi, kërkesat e qytetarëve dhe prioritetet zhvillimore të komunës së Drenasit. Fokus i veçantë I kësaj periudhe ka qenë në përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut dhe menaxhimin e qëndrueshëm të hapësirës urbane dhe mbrojtjes së mjedisit. Drejtoria ka shënuar progres të dukshëm në një sërë fushash kyçe të veprimtarisë së saj.

Aktivitetet kryesore të realizuara: Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2025, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është fokusuar në realizimin e planit të punës dhe të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e komunës tonë. Nder aktivitetet kryesore që janë realizuar gjatë kësaj periudhe raportuese janë:

Planifikimi hapësinor dhe legalizimi

- Trajtimi i kërkesave për legalizimin e objekteve pa leje në përputhje me Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.
- Pajisja e qytetarëve me leje ndërtimore për objekte të kategorisë I dhe II, në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor të miratuara.
- Lëshimi i Certifikatave të Përdorimit për objektet që kanë përmbushur kushtet ligjore dhe teknike të ndërtimit.

Mbrojtja e mjedisit

- Lëshimi i Lejeve Mjedisore Komunale (LMK) dhe Mendimeve Profesionale për objektet me ndikim në mjedis.
- Ndjekja e procedurave administrative për ruajtjen e standardeve mjedisore lokale.
- Rritja e hapësirave gjelbëruese sipas parashikimit të planit të punës.
- Aktivitete të shumta në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Emërtimi i rrugëve dhe regjistrimi i adresave

- Vazhdimi i projektit për vendosjen e tabelave me emra rrugësh dhe numrave të hyrjeve për objekte të ndryshme në tërë territorin e komunës.
- Harmonizimi i të dhënave me sistemin ARIS dhe regjistrimi i adresave në përputhje me të dhënat e gjendjes civile.
- Gjatë periudhës raportuese janë vendosur 87 numra adresash në terren.

Shërbime të tjera të urbanizmit

- Dhënia e pëlqimeve urbanistike për ndarje dhe bashkim parcelash, ndërtim objektivsh bujqësorë (p.sh. stalla) dhe ndryshim të destinimit të tokës.
- Përgatitja e dokumentacionit për komisione të ndryshme (vlerësime ofertash, mbikëqyrje teknike, plane zhvillimore etj.).

Aktiviteti	Sasia
Leje Ndërtimore për objekte të kategorisë I dhe II	20
Leje Mjedisore Komunale (LMK)	14
Mendime Profesionale për LMK	14
Vendime për Listë të Pritjes për objekte pa leje	18
Vendime për Legalizim të objekteve pa leje	19
Certifikata të Përdorimit	6
Aktvendime për ndërrim destinimi të tokës	13
Numra të rinj adresash të vendosur në terren	87

Arritjet dhe përmirësimet gjatë periudhës

- Digjitalizimi dhe përditësimi i të dhënave në sistemin ARIS dhe sinkronizimi me gjendjen civile.
- Përmirësimi i procedurave të aplikimit për leje ndërtimit
- Pjesëmarrje aktive në hartimin e strategjive zhvillimore komunale
- Përkrahja e iniciativave zhvillimore me rëndësi për komunën.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka realizuar me sukses shumicën e objektivave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës urbane, rritjen e transparencës dhe fuqizimin e shërbimeve publike për qytetarët e Komunës së Drenasit. Përgjatë pjesës së mbetur të vitit, drejtorja synon të vazhdojë me intensitet të njëjtë në përmbushjen e detyrave dhe implementimin e planeve zhvillimore.

Deri me datë 17.06.2025 Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka inkasuar të hyra në vlerë prej 230,973.53 € ose shprehur në përqindje 230.97%. Kjo tejkalon planin për periudhën raportuese dhe reflekton rritje të efikasitetit në menaxhimin operativ të DUMM.

Drejtoria e Inspeksionit

Raporti i Punës, Janar - Qershor 2025

Menaxhimi, arritjet kryesore, performanca kyçe në periudhën janar-qershor 2025 për realizimin e prioriteteve	Drejtoria e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar-qershor 2025 i ka kryer duke u bazuar në planin e punës. Gjatë periudhës raportuese janar –qershor 2025 inspektorët kanë sjellë raportet ditore të punës dhe janë hartuar raportet javore për punët e kryera në këtë Drejtori. Në vazhdimësi janë përcjellë dhe paguar të gjitha obligimet (faturat) për mallra dhe shërbime. Është hartuar zbatimi i planit të zotimeve dhe shpenzimeve për paga, mallra dhe shërbime për perioda për vitin 2025. Gjatë periudhës janar-qershor 2025 janë kryer punët dhe detyrat e punës nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon : • Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj. • Inspektimet e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, përcjellja sipas fazave të ndërtimit si dhe inspektimet finale. Ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme. • Inspektimi rreth ndotësve të ambientit, inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale. • Inspektimi i kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, taksit ilegal, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet, respektimi i shenjave të komunikacionit, etj. • Inspektimi i mënyrës së shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore, mendime profesionale për dhënie të LMK-ve, etj. • Inspektime lidhur me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, rrugëve, pastrimin e tyre nga akulli dhe bora, trotuareve, shesheve. Inspektime lidhur me mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, vendosjen e reklamave dhe panove të ndryshme, shfrytëzimin e hapësirave publike, etj. • Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren • Punë shtesë jashtë orarit të punës, kujdestari, ku kompensimi është bërë me ditë të lira dhe pagë.
--	--

Nga lëmia e Inspektorit të tregut	Nga lëmia e tregut për periudhën janar-qershor 2024 është bërë inspektimi mbi pajisjen me certifikata të biznesit, licencat, çmimet e mallrave të ekspozuara, mbarëvajtja e tregut në Drenas dhe Komoran, orari për fillimin dhe mbarimin e punës së barnatoreve, deklaracioni i mallit si dhe punëve tjera nga kjo lëmi. • Konform Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e Tregut nr. 03/L-181 janë inspektuar subjektet afariste (mallrat bazike elementare ushqimore vaj, miell etj.), rreth përmbushjes së standardeve të mallrave për vendosjen e tyre në treg, çmimeve, deklaracionit të mallit etj. • Po ashtu janë inspektuar furrat e bukës , kontrollimi i përdorimit të njësive matëse dhe peshoreve në qarkullim. • Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve. • Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve. • Lëshuarja e aktvendimeve (pëlqimeve) për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve afariste. • Janë bërë 194 inspektime, 114 procesverbale, 16 pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë, janë shqiptuar 34 gjoba mandatore në shumën prej 5,350.00 €.
Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit	Gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, inspektimet sipas fazave të ndërtimit si dhe inspektimet finale, mure rrethuese, rrethoja të ndryshme, etj. Aty ku janë hasur ndërtime pa leje nga inspektorët e ndërtimit është urdhëruar ndërprerja e punimeve ndërsa për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhrat e inspektorit janë marrë masa ndëshkuese si dhe janë zhvilluar procedurat e nevojshme që nga procesverbalet, aktvendimet për ndërprerje të punimeve, gjobat mandatore e deri te nxjerrja e draft-urdhrave për ekzekutim. Gjatë kësaj periudhe janë bërë: • Inspektimi i lejeve të ndërtimit • Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore). • Inspektimi i fazave të ndërtimit dhe inspektimet finale. • Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale. • Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen, instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore. • Gjatë kësaj periudhe janë bërë 123 inspektime, 87 procesverbale, 35 aktvendime për pezullim të punimeve dhe të ngjashme, 29 draft-urdhra për ekzekutim (në procedurë për konfirmim), si dhe 26 gjoba mandatore në shumë prej 36,000.00 €.

Nga lëmia e Inspektorit të Mjedisit	Në lëmine e mjedisit gjatë kësaj periudhë Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të mbeturinave, etj. Gjatë kësaj periudhe është bërë: • Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, parqeve dhe vendeve tjera publike. • Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime, • Inspektim dhe identifikim i deponive ilegale në tërë territorin e komunës së Drenasit, • Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj. • Inspektimi i Gurthyesve, dhe fabrikave të tjera që shkaktojnë ndotje në mjedis sipas kërkesave që kemi pasur; • Gjithsejtë janë bërë 48 inspektime, 33 procesverbale si dhe janë shqiptuar 3 gjoba mandatore në vlerë prej 750.00 €.
Nga lëmia e Inspektorit të Bujqësisë	Inspektori i Bujqësisë ka bërë mbikëqyrjen inspektuese rreth ruajtjes së tokave bujqësore dhe të komasacionit e sidomos rreth shfrytëzimit të tyre për bujqësi. Në kuadër të kësaj është përcjellë që tokës bujqësore të mos i ndërrohet destinimi pa pëlqim e që mos të fillojnë gjërmime apo rrafshime të terrenit për qëllime tjera në toka bujqësore. Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon: • Inspektimi i mënyrës së shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes, nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore. • Inspektimet e barnatoreve bujqësore dhe kontrollimi i imputeve bujqësore (farërat, plehurat artificiale). • Punët dhe detyrat tjera sipas urdhrit të Shefit apo Drejtorit. • Gjithsejtë janë bërë 63 inspektime, 54 procesverbale 9 aktvendime, 9 Urdhër rrënimë, 6 gjoba mandatore në vlerë prej 2,600.00 €.
Nga lëmia e Inspektorit të Shërbimeve Publike	Inspektori i Shërbimeve Publike ka bërë mbikëqyrjen e shfrytëzimit të pronës publike nga palë të treta, mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, rrugëve, trotuareve, shesheve etj. Inspektime lidhur me vendosjen e reklamave dhe panove të ndryshme, etj. Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon: • Inspektim i terasave që shfrytëzojnë hapësirat publike • Inspektime të rrugëve dhe trotuareve • Inspektim i mirëmbajtjes dhe pastërtisë së parqeve • Inspektime të ndryshme me kërkesa të palëve. • Gjatë kësaj periudhe janë bërë 61 inspektime, 46 procesverbale, dhe janë shqiptuar 10 gjoba mandatore në shumë prej 5,800.00 €.

Pasqyra e punës në shifra për periudhën janar-qershor 2025

Drejtoria e Inspektionit	Inspektime	Procesverbale	Aktvendime	Gjaba mandatorë	Vlera e gjobave në euro	Draft-urdh. Ekzek.	Rrëtime	Kallxime penale	Mbyllje të lokaleve	Konfiskim i targave dhe automjeteve
Treg	194	114	16	34	5,350.00	0	0	0	2	0
Ndërtim	123	87	35	26	36,000.00	29	0	10	0	0
Mjedis	48	33	1	3	750.00	0	0	0	0	0
Bujqësi	63	54	9	6	2,600.00	9	0	0	0	0
Shërbime Publike	61	46	0	10	5,800.00	0	0	0	0	0
Totali:	489	334	53	79	50,500.00	38	0	0	0	0

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

RAPORTI I PUNËS PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2025

1. Aktivitete në fushën e mjedisit

- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Tokës (22 prill) dhe Ditës Botërore të Mjedisit (5 qershor).
- Vazhdimi i aksionit "Bashkë për Pastërtinë në Komunën e Drenasit – Zemra e Kosovës", që do të zgjasë përgjatë gjithë vitit 2025.
- Pastrimi i hapësirave publike, brezave rrugorë dhe afërsive të shkollave.
- Identifikimi dhe ndërhyrja në deponi ilegale në territorin e komunës.

2. Menaxhimi i mbeturinave

- Zgjerimi i rrjetit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në bashkëpunim me KRM "Pastrimi".
- Hartimi i Raportit Vjetor për Mbeturina dhe konkurrimi për çmimin "Mjedis i Pastër".
- Regjistrimi i deponive ilegale në sistemin KEPA.
- Blerja e 296 kontejnerëve plastikë për përmirësim të shërbimeve.

3. Projektet kapitale dhe mirëmbajtja infrastrukturore

Përfshijnë:

- Rregullimi i varrezave në disa lokalitete (në proces prokurimi).
- Rehabilitimi i rrugëve të dëmtuara me kontratë kornizë (Drenas, Komoran, etj.).
- Vend ndalje për autobusë – 8 lokacione të reja.
- Zgjerimi i kamerave të sigurisë, përfshirë përgatitje për kontratë të re pas dëmtimit nga operatorët ekonomikë.
- Ndriçimi publik – në procedurë pas dështimit të parë të prokurimit.
- Shenjzimi vertikal dhe horizontal i rrugëve, përfshirë zonat shkollore.
- Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve.
- Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe rrugëve të kategorisë IV me zhavorr.
- Hapësirat gjelbëruese – kositje, krasitje, pastrim.
- Menaxhimi i deponisë inerte në Llapushnik – kontratë në zbatim.
- Intervenimet emergjente, mirëmbajtja e trotuareve dhe parkingjeve.
- Trajtimi i qenve endacakë – në partneritet me fondacionin StrayCoCo (Zvicër).
- Shërbimet e varrimit – bashkëpunim me Bashkësinë Islame.
- Eficienca e energjisë – renovimi i banesave sociale në bashkëpunim me FKEE.

4. Subvencione dhe transfere

- Subvencionim për familjet që kanë pësuar dëme nga zjarret.

5. Kërkesat dhe trajtimi administrativ

- Pranuar gjithsej: **265 kërkesa**, prej të cilave:
 - 200 të aprovuara
 - 10 të refuzuara
 - 1 e anuluar
 - 2 të hedhura poshtë
 - 1 e proceduar
 - 51 në proces
- Lënda përfshin kërkesa për kanalizime, shenjzim rrugësh, ndriçim publik, deponi, varreza, etj.
- Pagesat për shërbime komunale janë proceduar, megjithatë është identifikuar mungesë buxheti për shkak të ndërhyrjes nga Thesari. Kërkohej planifikim për bartje gjatë rishikimit të buxhetit në qershor/korrik.
- Hartimi i dokumenteve për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Drenasit.

6. Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit

- Trajtuar gjithsej: **106 raste**, prej tyre:
 - 91 raste zjarri
 - 5 shërbime të tjera
 - 6 intervenime teknike
 - 4 aksidente trafiku

7. Takime zyrtare dhe bashkëpunime

- Takimet e rregullta me Administratoret, KKSB dhe KLSP.
- Me GIZ dhe AMMK për raportimin dhe performancën e mbeturinave.
- Me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave.
- Me KEDS për mirëmbajtje të rrjetit.
- Me administratorët lokalë për menaxhimin e mbeturinave dhe shërbimet publike.

Në këtë periudhë gjashtëmujore, DShPE ka dëshmuar përkushtim dhe angazhim në ofrimin e shërbimeve publike cilësore dhe reagim të shpejtë në raste emergjente. Në vazhdimësi po punohet për përmirësimin e infrastrukturës, mirëmbajtjen e mjedisit dhe ngritjen e cilësisë së jetës për qytetarët e komunës së Drenasit.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

Raporti i punës për periudhën Janar-Qershor, 2025

Aktivitetet kryesore në Gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2025	Arritjet/progresi/përformanca kyçe e vitit 2025 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
--	---

Aktivitetet kulturore	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës në periudhën Janar- Qershor
	- Planin dhe programin e punës për vitin 2025, - Përgatitja e raportit vjetor të DKRS për vitin-2024, - Raporti gjashtë mujor për vitin 2025, - Kërkesat fillestare buxhetore, - Aktivitete në sektorët e DKRS-së - Takim individual me punëtorët e DKRS-së, - Vlerësimi i punëtoreve për vitin 2024, - Manifestimi për 17 shkurtin Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, filloi duke bërë homazhe tek të gjitha varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në komunën e Drenasit. - Punëtori dy ditore "Raportimin e të Dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës - Takim pune me grupin punues për realizimin e Planit të Strategjisë Komunale, - Është shënuar aktiviteti kulturor i Sofrës Poetike „Ymer Elshani” 2025, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve „Agim Deva”. - Organizimi i Akademive Përkujtimore, dhe mbledhjeve Komemorative, - Përgatitje e kërkesave fillestare për Buxhet të DKRS-së, 2026,2027,2028. - Me rastin e shënimit të 26 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe Bilborda, më datë 12.06.2025, ndërsa më 13.06.2025 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe në, Komplekset Memorial si dhe homazhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë. - Hapja e Ekspozitës nga z. Agim Bujupi në holin e Sallës së Kulturës për nder të 14 Qershorit Ditës së Çlirimit të Drenasit si dhe Shfaqja e Dokumentarit “Fatosi i Pëllumbave të Lirisë” kushtuar jetës dhe veprës së Heroit të Kosovës Fatos Sherif Krasniqi. Zyrtarja Administrative Punë Administrative të Përgjithshme në kuadër të DKRS-së • Mbajtja e protokollit të brendshëm për Drejtorinë dhe të gjithë sektorët përkatës në kuadër të DKRS-së (kulturë, rini, sport). • Pranimi dhe administrimi i faturave dhe kërkesave të ndryshme që i drejtohen DKRS-së. • Përpunimi dhe administrimi i lëndëve të DKRS-së në sistemin e Intranetit 242. • Përgatitja dhe dorëzimi i kërkesave për nevoja të ndryshme të DKRS-së, duke përfshirë edhe procedurat për pagesë. • Skanimi dhe arkivimi i dokumenteve të lëndëve zyrtare të DKRS-së. • Përgatitja e raporteve për nevojat e Drejtorisë dhe përcjellja e lëndëve për pagesë tek Drejtoria për Financa. • Pjesëmarrëse në punëtorinë 3 ditore në Brezovicë, për planifikimin e buxhetit dhe uebfaqes së re komunale Detyra dhe Projekte Shtesë të Kryera

- Përgatitja dhe menaxhimi i të dhënave në format Excel për të gjitha OJQ-të kulturore, sportive dhe rinore – përfshirë ndërtimin e databazës përkatëse.
- Hartimi i raporteve të komisionit për pranimin e mallrave të furnizuara për DKRS.
- Menaxhimi i kontratës “Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe”, përfshirë: Plotësimi i procedurave përmes sistemit E-prokurim, Hartimi i planit të menaxhimit të kontratës, Përgatitja e lëndëve për pagesë dhe përcjellja në Drejtorinë për Financa.
- Menaxhimi i kontratës “Furnizim me Invertor – Lot I dhe Lot II”.
- Menaxhimi i kontratës “Furnizim me hamburger dhe pije”.
- Menaxhimi i kontratës “Mirëmbajtja dhe pastrimi i Objektit të Komunës.
- Pjesëmarrje në Projektin e UNDP-së, Hartëzimi i institucioneve kulturore në Komunën e Drenasit - Faza 2;
- Kam bërë përgatitjen e paramasave të Projekteve për nevojat e DKRS-së;
- Pjesëmarrje në komisionet për furnizim me letër.
- Mbështetje administrative për organizimin e aktivitetëve të ndryshme nga DKRS, përfshirë:
- 17 Shkurti 2025 Dita e Pavarësisë së Kosovës.
